



Ulqin, me 14.01.2015

Konkurs për zgjidhje ideore për Maskotë

Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte – Komuna e Ulqinit, në kuadër të projektit “Zhvillimi i qendrueshëm i ekosistemit nëpërmes të mbrojtjes dhe kultivimit të faunës detare”, shpall konkurs për zgjidhje ideore të maskotës, me theks në temën e projektit të lartpërmendur.

Maskota duhet të simbolizojë pra, projektin në fjalë gjegjësisht zhvillimin e qendrueshëm të ekosistemit nëpërmes mbrojtjes dhe kultivimit të faunës detare, dhe promovimin dhe rritjen e ndërgjegjjes në drejtim të ruajtjes të ekosistemit detar, mbrojtjen dhe kultivimin e faunës detare, si dhe gjallesave detare në përgjithësi.

Gjithashtu të cekim një element të rëndësishëm që përmban ky projekt, dhe ky është ndalimi i peshkimit ilegal.

Që të plotësohet personazhi i maskotës, por që nuk është e detyrueshme, idejës së propozuar mund ti shtohet edhe ndonjë emërtim, gjegjësisht maskota e propozuar të ketë emrin vetor (si p.sh. emrat që hasim në peronazhe të vizatuara: Mickie Mouse, Donald Duck, Snoopie dhe të tilla.).

Shkurt për projektin:

PRIORITETET E KËTIJ PROJEKT JANË:

Mbrojta dhe promovimi i mbrotjes së ambientit;

QËLLIMET E KËTIJ PROJEKT:

Promovimi i mbrojtjes së ambientit, me qëllim avancimin e mekanizmave mbrojtjës dhe monitorimit të ekosistemit detar dhe rritjen e potencialit në peshkim për popullatën lokale nëpërmes zhvillimit të resurseve detare në rripin bregdetar.

Definicioni i maskotës:

Çfarë nënkuptojmë me fjalën Maskotë?

Maskotë është çfarëdo personi, kafshë, apo objekt, i cili konsiderohet se sjell fat apo çfarëdo objekti i cili përdoret për ta përfaqësuar një grup me një identitet publik të përbashkët, si p.sh. shkolla, ekip profesional sportiv, shoqatë, njësi ushtarake, apo edhe brend.

Maskotët gjithashtu përdoren si personazhe imagjinare, që prezantonjë një produkt i cili konsumohet, si p.sh. lepuri në një reklamë apo marketing për prodhime ushqimi apo konsumim për më të vegjlit.

Maskotët me kostume kanë gjetur përdorim të gjërë, dhe regullisht përdoren sikur përfaqësues gazmorë për ekipin e një komuniteti, kompani apo organizatë.

Mediat:

Ju njoftojmë se koncepti përfundimtar, gjegjësisht maskota e cila përzgjidhet si ideja më kreative dhe më interesante do shtypet në bluza, fes, promovim me Roll-Up, Bilbord, televizion, por që gjithashtu do shtypet edhe në letër në ngjyrë bardhë e zi, pra kocepti duhet të jetë i përshtatshëm për promovim në të gjitha mediat përkatëse.

Përgatitja:

Maskota duhet të përgatitet në formë vektor, ku do mund të hapet permes të software-it për dizejnim CorelDraw, versioni X6 si dhe versionet para tij.

Propozimet fillimisht mund të dërgohen në formatin JPEG, por që përgatitja duhet të jetë në formë vector, gjegjësisht në format .CDR.

Kufizimet:

Çdo konkurrues mund të propozojë deri në 5 propozime të zgjedhjes ideore për Maskotë.

Çdo propozim në fajll JPEG i cili dërgohet, nuk duhet të tejkalojë më shumë se 1 mb madhësi.

Komunikimi:

Ju njoftojmë se pasiqë të dërgoni propozim idejën tuaj, Zyra mban të drejtën që në komunikim me konkurruesin të propozojë ndryshime apo intervenime eventuale që të kompletohet propozimi, dhe të jepet një produkt final i cili mundësisht do rezultojë si zgjedhja fituese.

Kushtet:

Personi që dorëzon propozimet duhet të garantojë që koncepti i dorëzuar është origjinal, nuk është plagijat, është punuar nga vetë konkurruesi dhe që nuk bie ndesh me të drejtat e pronësisë apo të drejtat autoriale të personit tjetër. Poqese konstatohet që zgjedhja e dorëzuar është plagijat, konkurruesi diskualifikohet.

Andaj, të gjithë të aftësuarit në laminë e dizajnit – profesionalë apo amatorë, i ftojme që të dorëzojnë propozim- idejën e përgatitur të maskotës për projektin në fjalë.

Udhëzimet për aplikim:

- Propozimet konvertuara nga formati .CDR në formatin JPEG mund ti dërgoni në e-mail: gemal.hidrio@ul-gov.me, ku në fushën “subject” duhet ta shkruani tekstin: **PËR KONKURS: Maskota/ MNE-14/ 0020**

- Kopjoni tekstin më poshtë me titull “**Aplikim për konkurs**” dhe vendosni në e-mail të plotësuar me informatat e duhura.
- Gjithashtu zgjedhjen tuaj ideale mund ta dorëzoni personalisht në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Projekte në formë digjitale në Adesën Bulevardi Gj. K. Skenderbeu PN, Përmbi zyrën e fondacionit “NUR”.
- Afati i fundit për dorëzimin e propozim ideve është 30. Janar, 2015.
- Propozim ideja fituese do përzgjidhet nga përfaqësuesit e projektit në fjalë, ku do vlerësohet në bazë të kreativitetit, idejës dhe në bazë të përputhshmërisë së zgjedhjes së propozuar me konceptin e këtij projekt.

Çmimi fitues:

Konkurruesi i cili e përpilon zgjidhjen ideale më interesante dhe më kreative në temën e lartëpërmendur, do shpërblehet me një shumë me vlerë prej 300 €(**Treqind euro**).

Konkurruesi i cili shpallet si fitues doemosdo duhet të posedojë numrin e kontos bankare, për shkak të transferimit të të shumës fituese.

Teksti për aplikim: _____

- **Aplikim për konkurs “MASKOTA / MNE-14/ 0020” -**

Data:

(të ceket data e dorëzimit apo dërgimit të propozimit)

Konkurruesi:

(të ceket emri dhe mbiemri i konkurruesit)

E-mail adresa:

(të ceket e-mail adresa e konkurruesit)

Numri celular apo fiks për kontakt:

(të ceket kontakt telefoni i konkurruesit)

Po lajmërohem në konkursin për zgjidhje ideale për Maskotë për projektin “Zhvillimi i qendrueshëm i ekosistemit nëpërmes të mbrojtjes dhe kultivimit të faunës detare”, ku po konkurroj:

Me ____ propozime (të ceket numri i propozimeve)

Drejtuar: Komuna e Ulqinit

Zyra për bashkëpunim ndërkombëtar dhe projekte

Projekti “Zhvillimi i qendrueshëm i ekosistemit nëpërmes të mbrojtjes dhe kultivimit të faunës detare”

Si konkurrues garantoj që zgjedhjet ideale të dorëzuara janë zhvilluar nga une dhe se nuk bijnë ndesh me të drejtat e pronësisë apo të drejtat autoriale të personit tjetër.